



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
TIRANË**

V E N D I M

Nr. 68, datë 06.12.2007

**« MBI MIRATIMIN NE PARIM TE DHENIES ME QIRA TE OBJEKTEVE ME
SIPERFAQE 200 – 500 M² TE PASURIVE TE NDERRMARJEVE NE
ADMINISTRIM TE BASHKISE »**

Bazuar në Ligjin Nr.8652, dt.31.07.2000, neni 32, gërma "e", "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", V.K.M. Nr.378, dt.12.08.1999 "Për kalimin e të drejtës së përfaqësuesit të pronarit, për disa objekte pronë publike, organeve të qeverisjes vendore", pika 1, V.K.M, Nr.162, date 07.03.2007 "Për dhënien me qira ose enfiteozë të pasurive të ndërmarrjeve, shoqërive dhe të institucioneve shtetërore", pas shqyrtimit të relacionit të paraqitur nga Drejtoria e Administrimit të Aseteve, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I

1. Miratimin e dhënies me qira të objekteve me sipërfaqe 200-500 m², për një periudhë 5 vjeçare, në varësi të Bashkisë së Tiranës, si më poshtë:
 - **Ndërmarrja Metalike "Tirana"**
Objekti "Magazinë e Lëndës së parë" Sip 500 m²
2. Ky proces të kryhet nëpërmjet procedurave të konkurimit publik dhe elementëve të tij në mbështetje të V.K.M Nr.162, dt.07.03.2007.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohen, Drejtoria e Administrimit të Aseteve dhe Ndërmarrja Metalike "Tirana".
4. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sokol Dervishaj

K R Y E T A R